



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 163/13 prot.

Tiranë, më 03.07.2023

**VENDIM**

**Nr. 49, datë 03.07.2023**

**PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 36, DATË 29.05.2023**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr.36, datë 29.05.2023, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të pretendimeve të nëpunësit \*\*\*\*\*”, për mosrespektim të rregullave të legjislacionit të shërbimit civil, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpunësi Civil \*\*\*\*\* , nëpërmjet një informacioni regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 163 prot., dhe nr. 163/1 prot., datë 10.02.2023, përmes të cilit ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procesit të realizimit të dy vlerësimeve negative të rezultateve në punë, për periudhat 01.01.2022-30.06.2022 dhe 01.07.2022-04.11.2022, në bazë të të cilave, njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka nxjerrë aktin (Vendim) nr. 3, datë 08.02.2023, për përfundimin e marrëdhënies së tij në shërbimin civil.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 36, datë 29.05.2023, të Komisionerit, *“Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.36, datë 29.05.2023, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të pretendimeve të nëpunësit \*\*\*\*\*, për mosrespektim të rregullave të legjislacionit të shërbimit civil, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”.*

Brenda afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, institucioni ka informuar Komisionerin në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të këtij rasti, duke dërguar edhe dokumentacionin përkatës.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 36, datë 29.05.2023, si dhe duke verifikuar dokumentacionin bashkëlidhur shkresës nr. 530/3 Prot., datë 12.06.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, drejtuar Komisionerit, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Rezulton se, me shkresën nr. 530/3 Prot., datë 12.06.2023, *“Mbi Vendimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, të DPSHP, protokolluar pranë Komisionerit me nr.530/3 Prot., datë 12.06.2023, jemi njohur me kërkesëpadinë e cila është ngritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse \*\*\*\*\* , palë e paditur DPSHP me objekt shfuqizimin e akteve të lirimit nga shërbimi civil për shkak të dy vlerësimeve *“Jo kënaqshëm”* të rezultave në punë.

Në kushtet kur çështja objekt i vendimit paralajmëruar të Komisionerit do të zgjidhet përfundimisht në rrugë gjyqësore, vlerësoj se, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, si dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak të juridiksionit që tashmë i përket gjykatës, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.36, datë 29.05.2023, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të pretendimeve të nëpunësit \*\*\*\*\*, për mosrespektim të rregullave të legjislacionit të shërbimit civil, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”.*

2. Për këtë vendim të njoftohet, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës si dhe punonjësi \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**